



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 45/3 prot.

Tiranë, më 13.07.2021

**VENDIM**  
**Nr.96, datë 13.07.2021**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË**  
**VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 92, DATË 15.9.2020**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit të Komisionerit Nr. 92, datë 15.9.2020, “Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë të procedurës së lirimit nga shërbimi civil të nëpunësit \*\*\*\*\*”, në detyrën “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë”.

**KONSTATOVA SE:**

Nëpërmjet kërkesës nr. 479 prot., datë 01.06.2020, nëpunësi \*\*\*\*\* ka ngritur disa pretendime për parregullsi dhe shkelje në zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, gjatë kryerjes së procesit administrativ të lirimit të tij nga detyra, komunikuar me aktin nr.238, datë 06.09.2019, të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, “Lirim nga detyra” të Drejtorit të Burimeve Njerëzore, \*\*\*\*\*.

Për verifikimin e informacionit, Komisioneri ka kryer hetimin administrativ të këtij rasti, duke kërkuar nga institucioni i Bashkisë Rrogozhinë të dërgojë të gjithë dokumentacionin që disponon në lidhje me këtë rast.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 92, datë 15.9.2020, “Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë të procedurës së lirimit nga shërbimi civil të nëpunësit \*\*\*\*\*”, në detyrën “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”, në Bashkinë Rrogozhinë”.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr. 92, datë 15.9.2020, si dhe duke verifikuar veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, të materializuara në dokumentet shkresore përkatëse, situata e administrimit të shërbimit civil për rastin në fjalë në institucionin e Bashkisë Rrogozhinë paraqitet si më poshtë vijon:

Në pikën 1 dhe 2, Komisioneri ka kërkuar nga organi publik, Kryetari i Bashkisë Rrogozhinë, të anulojë si të paligjshëm aktin administrativ nr. 238, datë 06.09.2019, për lirim nga shërbimi civil të nëpunësit \*\*\*\*\*, si dhe rikthimin e tij në pozicionin e mëparshëm nëse pozicioni është ende i lirë, ose nëse ai është zënë përfundimisht, të sistemohet në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, të të njëjtës kategori.

Me shkresën nr. 381/1 prot., datë 21.01.2021, “*Kthim përgjigje*”, Bashkia Rrogozhinë ka informuar Komisionerin se nëpunësi \*\*\*\*\* i është drejtuar gjykatës me kërkesë-padi me të njëjtin objekt kërkimi.

Ndodhur në këto rrethana, bazuar në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “*Kodi i Procedurës Civile*”, i ndyshuar, Kreu II, neni 36, në të cilin parashikohet se:

*“Në juridiksionin e gjykatave hyjnë të gjitha mosmarrëveshjet civile dhe mosmarrëveshjet e tjera të parashikuara në këtë Kod e në ligje të veçanta. Juridiksioni gjyqësor civil ushtrohet sipas dispozitave të këtij Kodi dhe ligjeve të tjera.*”

**Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.**

*Është e pavlefshme çdo marrëveshje që lidhet në kundërshtim me këtë dispozitë.”*

Vlerësoj se, Komisioneri, nuk mund të vijojë më tej procesin e mbikëqyrjes në vazhdim për këtë rast.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*” dhe Rregulloren, “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të mbikëqyrjes në vazhdim të Vendimit Nr. 92, datë 15.9.2020, “*Mbi përfundimin e verifikimit të ligjshmërisë të procedurës së lirit nga*

*shërbimi civil të nënpunësit \*\*\*\*\*, në detyrën “Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse”,  
në Bashkinë Rrogozhinë”.*

2. Për këtë vendim të njoftohet Bashkia Rrogozhinë dhe ankuesi \*\*\*\*\*.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**